



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së katërt të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, e mbajtur më 15.10.2020, e cila filloi në orën 13:30.

Në mbledhje morën pjesë: **Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, anëtarët e Komitetit: Mehreme Llumnica, Ramadan Salihu, Jeton Canhasi dhe Gyltene Retkoceri.**

Munguan: Armend Ademi dhe Ermira Shabani.

Të pranishme ishin edhe **Premtime Preniqi, koordinatore e Njësisë për të drejtat e njeriut, Saranda Tara, Fitim Rexha, drejtori i Drejtorisë së Sportit, Albulena Ahmeti, përfaqësuese nga Drejtoria e Arsimit, Luljeta Domaniku përfaqësuese nga Avokati i Popullit, Mexhid Foniqi, drejtor i Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, Ujup Rashica, kryetar i Shoqatës së të Verbërve të Prishtinës dhe Mirsad Mulla.**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, me këtë**

REND DITE:

Organizimi për 15 tetor - Dita Ndërkombëtare e Njeriut me Shkop të Bardhë.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, i përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi të pranishmit në pika të shkurtra lidhur me organizimin për nder të Ditës Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop të Bardhë.

Ajo tha se edhe në vendin tonë, që nga vitet e tetëdhjeta, në kujdesin e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, shënohet kjo ditë e rëndësishme, e cila në mënyrë të veçantë i bashkon të verbrit në veprimtari të ndryshme në nivel lokal e kombëtar, që kanë për qëllim sensibilizimin e institucioneve shtetërore dhe shoqërisë për përmirësimin e realizimit në praktikë të të drejtave që atyre u jep statusi i të verbrit, por shërben edhe për promovimin e vlerave që këta persona mund të ofrojnë në shoqëri.

Në kuadër të të ashtuquajturit "Muaji i mundësive të barabarta", vite me radhë, Komuna e Prishtinës i hap dyert për persona me aftësi të kufizuara, brenda kësaj edhe për të verbër, duke u dhënë mundësinë një numri prej tyre t'i tregojnë aftësimet profesionale dhe aftësitë e

veta për punë. Për këtë lloj kontakti dyditor të njohjes mes Komunës dhe këtyre personave, atyre u jepen edhe mëditje.

Qëllimi i shënimit të kësaj date është, që publiku të njihet me atë se çka është verbëria dhe si të verbrit dhe me të parë të dobësuar mund të jetojnë dhe punojnë në mënyrë të pavarur dhe t'i kontribuojnë bashkësisë së tyre.

Komiteti apelon në institucionet komunale, që t'i plotësojnë obligimet e veta nga Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, nga legjislacioni ynë përkatës, në veçanti nga Ligji për personat e verbër.

Ne ftojmë dhe inkurajojmë Komunitetin e të verbërve të bashkëpunojë me Komitetin për persona me aftësi të kufizuara, sikurse që kërkojmë nga Komuna e Prishtinës që t'i përmbushë obligimet e veta ligjore ndaj këtyre qytetarëve.

Luljeta Domaniku, nga Institucioni i Avokatit të Popullit, i përshëndeti të pranishmit dhe në pika të shkurta dha sqarime lidhur me institucionin, duke thënë se institucioni është kushtetues, i cili ka mandatin për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, gjithashtu institucioni mbikëqyrë dhe promovon të drejtat e personave me nevoja të veçanta, por edhe personave të verbër.

Në bazë të ankesave të pranuar në Institucionin e Avokatit të Popullit, në shumicën e raporteve të publikuara është konstatuar se personat me nevoja të veçanta dhe të verbrit, vazhdojnë të përballen me shumë vështirësi në shumë fusha të jetës, si në punësim, qasje në hapësira publike dhe institucione publike, në transport publik dhe vështirësi në realizimin e të drejtave në beneficione të garantuara sipas legjislacionit në fuqi. Po ashtu, ceku edhe disa nga barrierat me të cilat ballafaqohen personat e verbër në Kosovë, e që janë edhe mungesa e shtigjeve të prekshme, semaforët e zëshëm, publikimet dhe njoftimet (problemet) në alfabetin e Brajlit në institucione etj.

Po ashtu, Avokati i Popullit në Kosovë ka vërejtë se ende nuk ka statistika të sakta zyrtare rreth numrit të përgjithshëm të personave me aftësi të kufizuara, ku ai konsideron se mungesa e një baze të të dhënave për këtë kategori, pamundëson adresimin e duhur nga institucionet politike-hartuese.

Po ashtu, ceku disa raporte rreth të cilat i ka publikuar si institucion lidhur me personat e verbër, një raport e kemi pasur nga OJQ "Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës", parashtruar kundër Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, përkitazi me mos lirim nga pagesa të personave të verbër në dalje të objektit të QKUK-së. Avokati i Popullit në këtë rast konstaton se edhe pse Ligji nr. 04/L-092 për personat e verbër përcakton: "Personat e verbër lirohen nga çdo lloj takse dhe tatimi", ky obligim ligjor nuk ishte duke u respektuar nga QKUK.

Një raport tjetër që ka qenë i publikuar nga institucioni, ka qenë në lidhje me beneficionet e personave me aftësi të kufizuar për importin, e që ka të bëjë me importin e automjeteve. Sa i përket Ligjit për PAK dhe Kodit doganor, PAK kanë të drejt të importojnë, por kushti i parë ka qenë me pasur patentë shoferin ai person, dhe kushti i dytë ka qenë automjeti t'i përshtatet aftësisë së kufizuar të personit. Sa i përket personave të verbër, kjo ka qenë e

punësimin e tyre në institucione publike në Komunë e Gjilanit. Konstatimi i Avokatit të Popullit është, se Komuna e Gjilanit ka dështuar t'i zbatojë dhe t'i përmbushë obligimet që burojnë nga Ligji për aftësim, riaftësim profesional dhe punësimin e PAK-së, duke mos përmbushur numrin e nevojshëm të të punësuarve nga radhët e PAK-së.

Raport tjetër që është publikuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, është lidhur me Komunën e Gjakovës, ku Avokati i Popullit thotë se personat e verbër duhet të lirohen nga pagesa e taksës në pronë, që d.m.th. sipas Ligjit mendon edhe për këto raste Komuna e Gjakovës e ka implementuar rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Sa u përket informatave të tjera, ajo tha se unë konkretisht e kam pasur një rast tjetër të një person të verbër nga Komuna e Gjakovës, i cili para disa ditëve është punësuar, ka qenë në lidhje me punësimin, ne kemi kontaktuar me Agjencinë për Punësim në Gjakovë dhe është arritur marrëveshja që personi është punësuar te Avokati, e siç me ka informuar, ka një kontratë gjashtëmujore me mundësi vazhdimi.

Fatime Demolli - Mustafa tha se kur është fjala për importin e makinave për personat me aftësi të kufizuara, personat e verbër në këtë rast e kanë shoqëruesin e tyre, a kishte mundur në këtë aspekt që të paktën makina të regjistrohet në emër të shoqëruesit të tyre, sepse ligjërishit ju takon një gjë e tillë ta paraqesin edhe shoqëruesin.

Mexhid Foniqi, drejtor i Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, e falënderoi Komitetin KPAK për shënimin e kësaj Jave Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop të Bardhë, e cila shënohet tash e 57 vjet në mbarë botën.

Desha të ndalem te rekomandimet që i përmendi zonja Luljeta. Pikë së pari, prej ankesës te Avokati i Popullit për lirimin nga taksat e tatimeve, neni i 6 i Ligjit për personat e verbër thotë: Të gjithë të verbrit të lirohen nga çdo lloj takse të tatimit, ku këtu edhe Kuvendi Komunal i Prishtinës po e shkel atë ligj, se në faktin se në vitin 2018 ka miratuar një Rregullore për lirimin nga tatimi në pronë për personat e verbër, e që as sot asnjë i verbët nuk e ka gëzuar këtë të drejtë.

Çështje tjetër ishte çështje e energjisë elektrike, edhe për këtë lirohen nga tatimi në bazë të Ligjit të personave të verbët, ku Shoqata e të Verbërve të Gjakovës ka bërë ankesë në Gjykatën Themelore të Prishtinës, dhe e ka fituar të drejtën që qytetarët e komunës së Gjakovës lirohen nga tatimi, ndërsa qytetarët e Prishtinës dhe qendrave të tjera nuk e gëzojnë atë të drejtë.

Çështje tjetër është edhe lirimi nga importimi i automjeteve, ku para luftës ka qenë ajo e drejtë edhe për të verbrit, ndërsa tash është e kushtëzuar me marrjen e patentë shoferit, gjë që është e pakapshme për personat e verbër, dhe në kontakt me Zyrën Ligjore të Doganave, kemi arritur një marrëveshje që do të amandamentohet kodi doganor, por fatkeqësisht ende nuk është amandamentuar edhe e njëjta ka mbetur, kështu që personat tjerë me dëmtime fizike me adaptimin e veturës ata mund ta përdorin këtë, ndërsa të verbëritë jo.

Po ashtu e ceku edhe çështjen e shkollave, ku në shkolla fillore të komunës së Prishtinës, në qytet, afër 20 nxënës e vijojnë mësimin në mësimin gjithëpërfshirës, përderisa nuk ka asnjë asistent për nxënësit e verbët. Ata janë të privuar edhe nga e drejta e shkrimit dhe leximit Brajt, ku ata vijojnë mësimin pa pasur mundësi me marrë shënime, nuk kanë as pajisje adekuate - makinë të Brajtit apo ndonjë diktafon etj., kështu që DKA-ja duhet të bëjë në atë

Drejtimit, që të sigurojë asistente për ata nxënës të cilët e kanë shikimin të humbur thuajse se 100%, vijojnë mësimin në shkollë të rëndomta.

Çështja tjetër është ajo e punësimit të kolegut tonë, ai është magjistër i Shkencave Juridike, i cili është punësuar përkohësisht, me kontratë 6 mujore, po shpresojmë se ai me siguri do ta dëshmojë veten si punëtor dhe do të vazhdojë me punuar.

Fatime Demolli - Mustafa tha se sa i përket arsimit të fëmijëve, që janë 20 nxënës të cilët e vijojnë mësimin, ne e kemi Qendrën burimore për mësim dhe këshillim "Xheladin Deda" në Pejë, por kjo Qendër duhet t'ju ndihmojë edhe këtyre 20 personave, të cilët i kemi të paktën me ndonjë makinë Brajt, me ndonjë material i cili iu duhet këtyre nxënësve.

Albulena Ahmeti, përfaqësuese nga Drejtoria e Arsimit, tha se si DKA do t'ju sigurojmë se mbetemi të përkushtuar me punë si mbështetje institucionale, duke marrë parasysh nevojat të cilat janë dhe kushtet të cilat i kemi. Jemi të vetëdijshëm se kemi shumë punë për të arritur objektivat, dhe me pasur një qasje integrimi në fushën e arsimit, por për me arritur këtë, ne duhet pasur bashkëpunim institucional edhe me organizata dhe shoqata të ndryshme, të cilat i mbrojnë interesat e grupeve të caktuara. Sa i përket asistentëve, është një procedurë e cila tash e dy vjet nuk është arritur të aplikohet punësimi i këtyre asistentëve. Kam biseduar edhe me udhëheqësin e Zyrës së burimeve njerëzore, ku sipas tyre, më 15 nëntor është koha kur vendoset se sa lejohet punësimi i asistentëve, se është dhënë si numër 12, por në anën tjetër nuk mundemi me i futur në listë të pagave. Ky është ai problemi që e ka zvarritur shumë këtë procedurë.

Po ashtu, sugjeroi që të kenë edhe takime të tjera me përfaqësues të Ministrisë, drejtorë të shkollave, prindër, dhe bashkërisht me i pa dhe me i adresuar proceduralisht se si mundemi me i rregulluar këto probleme.

Fitim Rexha, drejtori i Drejtorisë së Sportit, tha se ne si drejtori kemi qenë të hapur për bashkëpunim me shoqatat të ndryshme të këtij komuniteti që veprojnë në komunën e Prishtinës. Ne si drejtori ndajmë subvencione, në dy faza, për Rini dhe Sport, ku në këto subvencione mund të përfshihen edhe shoqatat e komunitetit të të verbërve për aktivitete të ndryshme të tyre, si sportive, ku përfshihet rinia e tyre dhe manifestime të ndryshme të tyre. Me këtë rast ne i ftojmë ata të aplikojnë. I kemi përkrahur në të kaluarën dhe do t'i përkrahim edhe në të ardhmen, andaj ju ftoj për bashkëpunim, që ta inkorporojmë në këtë rast alfabetin Brajt, që edhe aplikimi i Shoqatave të të verbërve në Komunën e Prishtinës të jenë më të lehta. Po ashtu, ceku se nga viti i ardhshëm kjo drejtoria do të ketë mundësi buxhetore që edhe vetë të jetë organizatore, kështu që ju ftoj së bashku për ndonjë aktivitet që e shënoni ju si komunitete, organizata apo OJQ, që bashkërisht të shënojmë evenimente të tilla.

Fatime Demolli - Mustafa tha se ne do ta kemi edhe 10 dhjetorin, ku do ta shënojmë Ditën Ndërkombëtare të PAK, ndoshta aty do të kemi ndonjë nevojë për një subvencion, mirëpo datat e aplikimeve po besoj se janë në ueb-faqen tuaj kur duhet të aplikuar, ose janë gjithmonë të hapura edhe online.

Ujup Rashica, Kryetar i Shoqatës së të Verbërve të Prishtinës, tha se kjo shoqatë përfshinë 6 komuna. Sa i përket komunës së Prishtinës, janë 60 anëtarë të verbër dhe me të parë të dobësuar. Ne si shoqatë bëjmë projekte, bëjmë kërkesa dhe ia dërgojmë Kuvendit komunal, duke përfshirë të gjitha aktivitetet vjetore.

Ne kemi 11 nxënës vetëm në regjionin e Prishtinës, të cilat janë shkollat e bashkangjitura, që për neve më duket që e kemi mbuluar një sektor të arsimit, por është i mangët, është i mangët sepse nuk i kanë asistentët, nuk i kanë mjetet adekuate për nxjerrjen e mësimëve, andaj ne e kemi paraprirë këtë program, por kërkojmë mjete, sepse Shoqata e të Verbërve ia ofron këto shërbime, si në shkrim dhe lexim të Brajtit, si në teknologji informative etj. Sa i përket teknologjisë informative, e falënderojmë Kuvendin komunal se përmes donatorëve na ka siguruar një printer, mirëpo ende nuk e kemi licencën, se na duhen mjete për blerjen e licencës së tij.

Sa i përket infrastrukturës, ajo mungon. Ne çdo vite kërkojmë shkopinj të bardhë, Komuna nuk ofron, shoqata na ofron përmes donacioneve. Ne çka kërkojmë është, të na përkrah për këto projekte, që janë shumë të domosdoshme për komunitetin tonë. Ne po kërkojmë vetëm të respektohet Ligji për personat e verbët, sidomos i bëj apel Kuvendit komunal, ato që janë në kompetenca të saj, si në arsim, Mirëqenie Sociale, Shëndetësi, t'i implementojë me anë të Rregullores.

Premtime Preniqi tha se sa i përket kësaj pozite që jam unë, zyrtare për të drejtat e PAK, kemi punuar pa kufi në këtë drejtim, mirëpo ka shumë punë në këtë drejtim të rregullimit të të drejtave të PAK. Probleme të përgjithshme, sidomos të PAK, kemi pasur gjithmonë, edhe do të kemi ende, mirëpo si Komunë me themelimin e Komitetit KPAK, ka filluar me u vetëdijesuar edhe më tepër njerëzimi dhe stafi komunal lidhur me këtë kategori të shoqërisë sonë. Po ashtu, ceku se ka dhjetë vjet që mbahet fushata "Tetori i mundësive të barabarta", shpërndarja e këtyre personave të cilët edhe paguhen për ato ditë, të cilët vinë në mënyrë simbolike me treguar aftësinë e tyre, mirëpo këtë vit për shkak të pandemisë nuk është organizuar, mirëpo në bashkëpunim me KPAK, kemi menduar se është e rrugës një lloj promovimi të mbahet për ditët më të veçanta të secilës kategori të PAK. Se sa është bërë në Komunën e Prishtinës për PAK, unë nuk jam e kënaqur, nuk kemi rrugë të cilat i ofrojnë personave të kategorive të ndryshme, si të verbërve, personave me karrocë etj., kemi probleme të ndryshme, si te punësimi, arsimi etj.

Shpresoj të kemi një punë më me prioritet se të tjerët, ne jo që i kemi punët krejt në rregull, mirëpo në qoftë se nuk arrijmë qëllimin edhe kategoritë tjera me i inkorporuar në këtë zhvillim shoqëror, atëherë do me thënë se ne jemi shumë mbrapa. Mos integrimi i tyre, këtyre dy kategorive, si barazisë gjinore gjithashtu edhe PAK, me të vërtetë është një dëm i madh për shoqërinë, dhe aty na tregon neve çfarë shoqërie jemi dhe sa jemi të fortë me ndërtuar një shtet.

Ramadan Salihu tha se sipas të dhënave të Organizatës Botërore të të Verbërve, në botë janë 285 milionë të verbër, në Kosovë janë rreth 5 mijë, në Prishtinë janë 250, shprehur në përqindje i bie 4.2 % e popullatës botërore, 0.2% e kësaj popullatës nacionale, dhe 0.1 e popullatës lokale. Shifra prej 0.1% deri 4.2% është shumë dallues, e dimë se për Komunën është shumë më barrë e lehtë me i plotësuar nevojat dhe kërkesat e këtyre qytetarëve sesa që është për Republikën, që është shifra më e madhe sesa që janë në rajonet tjera dhe nivel ndërkombëtar.

Këtu e kemi përfaqësuesin e Avokatit të Popullit, i cili institucion përpos përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore, është një ndër institucionet më të besueshme, sipas publikimeve që dalin nëpërmjet mjeteve të informimit. Përfaqësuesja i përmendi disa ndërhyrje ex officio, por

Prishtinën nuk e përmendi, e përmendi Gjakovën, Gjilanin, Ligjshmëria, zbatueshmëria e ligjshmërisë më së shumti lëngon në Prishtinë, për faktin se është qendra më e madhe, andaj shikoni edhe këndej si është raporti, 50:1, do të shihni ka shumë punë për ju.

Po ashtu, për Avokatin e Popullit dhe zotëri Mexhidin e parashtroj një kërkesë, se faksimili vetëm në Kosovë nuk iu ndihet si nënshkrim për personat e verbër, kjo nga Ligji 03/L 010, për noterin, i cili në nenin 40, paragrafi 1, nënparagrafi 2 e sanksionon këtë pamundësi, dhe të verbrit për të vepruar juridikisht duhen ti kenë dy dëshmitarë çka është diskriminuese, ligji është i tillë, andaj Avokati i Popullit të reagojë dhe të shikojë se a ka mundësi që ky paragraf ligjor të korrigojohet, të amandamentohet, apo të futen mekanizma të tjerë juridik që i verbëri të konsiderohet subjekt i mëvetësishëm në aktivitetet e veta, qoftë në institucione shtetërore, në ekonomi, në OJQ e tjera përmes faksimilet të vet.

Kërkesa tjetër është te Ligji 04/L131, për skemat pensionale të financuara nga shteti, neni 8, paragrafi 3 e pamundëson marrjen e kompensimit të verbësisë në qoftë se i verbëri i mbushë 65 vjet, kjo është më se diskriminuese.

Mehreme Llumnica tha se KKPAAK sa i përket gjithë përfshirjes, e di se Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me Save Children dhe me OJQ-të, kanë bërë një punë shumë të madhe për gjithëpërfshirje, kanë intervistuar shumë problematika, problematika përveç asistentit që është e pazgjdhshme, problem në hapin e parë për gjithëpërfshirje është komisioni vlerësues, që e pengon përfshirjen edhe përjashtimin e PAAK qysh në fillim. Nuk mbahet me kohë, është një ekip jo funksional, ndoshta shkon gjysma e vitit derisa t'i vije radha me u vlerësuar një fëmijë a me u përfshirë në edukimin e rregullt, apo për ndonjë edukim më të veçantë ose më special, ju si zyrtare e arsimit merrni masa për këtë çështje ose ta rrisni numrin e ekipit etj.

Te çështja e punësimit, te kjo përfaqësuesja e Avokatit të Popullit isha fokusuar, se komiteti ka punuar shumë në këtë lëmë, ka bërë hulumtime në Komunën e Prishtinës, është një pasqyrë shumë tragjike për të dhëna, edhe kemi marrë iniciativë shkakut pse është kaq i vogël numri i PAAK në kontakt me Burimet njerëzore. Kemi përgjigje të palogjikshme, se nuk përputhet Ligji i punës me Ligjin për shërbyes civilë! Nëse është Ligji tash për mbrojtjen nga diskriminimi, shumë letë munden me u marrë masa alternative, ose do të marrim iniciativë ta korrigojmë Ligjin për shërbyes civilë dhe Ligjin e punës, që të mos kemi dilema. Ne për mos me ardhur deri te diskriminimi, i kemi arritur një marrëveshje me Burimet njerëzore, me aplikacion të certifikohet edhe një rubrikë që është PAAK.

Njëherësh pyeti përfaqësuesen nga Avokati i Popullit, si kanë arrit me e punësuar atë magjistrin e verbër, që ka pritur një kohë të gjatë dhe në çfarë mënyre keni shkuar, me konkurs të rregullt apo si e keni arritur.

Luljeta Domaniku dha sqarime lidhur me këtë pyetje të parashtuar.

Premtime Preniqi pyeti se sa punëtor i ka Institucioni i Avokatit të Popullit dhe sa janë me aftësi të kufizuara.

Luljeta Domaniku, tha se deri tani janë 70 punëtorë, me aftësi të kufizuara kemi pasur edhe zotëri Ramadanin, ka qenë i punësuar te ne si praktikant, po kemi pasur rast edhe kur tash personi është gjyqtar në Gjykatën Themelore, ka punuar një kolege e cila ka qenë me aftësi të kufizuara, tani është gjyqtare në Gjykatën e Apelit, kemi pasur edhe një përkthyes.

Premtime Preniqi tha se këtu është problemi kryesor, ndoshta se vetë njerëzit që pe mbrojnë këtë kategori të personave, e në anën tjetër vetë e shkelin, e njëjta po ndodh edhe në nivelin qendror, ku është Zyra për mundësi të barabarta, e aftësive të kufizuara dhe, në anën tjetër, nuk e ka asnjë person të punësuar me aftësi të kufizuara, mandej kur po donë me kërkuar ndihmë, po është shumë ma e vështirë se po kërkon ndihmë prej dikujt që pe shkelë vetë atë të drejtë.

Luljeta Domaniku, pyeti se sa persona me aftësi të kufizuara i ka të punësuar Komuna e Prishtinës.

Premtime Preniqi tha se Komuna e Prishtinës vetëm brenda, pa institucione përcjellëse, i ka vetëm 3, që nuk plotësohet kushti aspak, ndërsa nëse shkon me institucione përcjellëse, shkon numri diku 13 persona, por prapë nuk është numër i kënaqshëm.

Mehrema Llumnica tha se shumë më e rëndë është se nuk janë nëpër pozita, profilet që i kanë ndoshta teknik, janë në pozita më të ulëta.

Premtime Preniqi tha se në Komunën e Prishtinës faktikisht ne e kemi një jurist, një telefonist dhe një pozitë ma të ultë, por prapë se prapë unë kam njerëz të cilët gjatë fushatave që i kemi mbajtur edhe përpara, që ndoshta zero mundemi me thënë i kishin lënë shumë zyrtarë tanë komunalë, janë më përgjegjës, më punëtorë, me njohuri shumë më të mëdha, mirëpo ata nuk punësohen.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, e mbylli takimin, duke i falënderuar secilin nga të pranishmit për kontributin e dhënë në këtë ditë të shënuar.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami

Kryesuesja e Komitetit
Fatime Demolli - Mustafa

